



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.516/15

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, rr...., nr..., kundër të paditurit Z. S. Sh. nga fshati A., Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 456,44 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 29.10.2015, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, rr...., nr..., andaj **detyrohet** i padituri Z. S. Sh. nga fshati A. komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, t'ia paguajë paditëses shumën në lartësi prej 456,44 euro dhe atë me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, të llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 15 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor për këtë çështje juridiko kontestimore është mbajtur në mungesë të palës së paditur Z. S. Sh. nga fshati A. komuna e Prizrenit, konform nenit 423.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Pretendimet e palëve

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, rr...., nr..., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit Z. S. Sh. nga fshati A. komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit, përmes së cilës ka theksuar se me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.443/10, të datës 09.10.2014, këtu i padituri është shpallur fajtor për verpën penale të vjedhjes, ndërsa që paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Sipas padisë, i padituri, në mënyrë të kundërligjshme dhe të pa autorizuar prej datës së pavërtetuar e deri me datën 18.01.2010, me qëllim që t'i sjell vetës pasuri të kundërligjshme e ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, duke përdorur njësin elektrik, ashtu që ka bërë manipulim, ku nga ana e majtë e ka futur shiritin filmik dhe përmes tij e ka

penguar punën e diskut me ç'rast energjia e shpenzuar nuk është regjistruar dhe në këtë mënyrë paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 456,44 euro, andaj edhe nga gjykata është kërkuar që të aprovet kërkesëpadija, ashtu që të detyrohet i padituri që t'ia kompensojë dëmin paditëses në shumën e lartcekur.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, e autorizuar e paditëses Y. M. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve të cekura në padi dhe kërkesëpadi. Në fjalën e saj të fundit ka deklaruar se nga provat e administruar pa dyshim është vërtetuar kërkesëpadija e paditëses në shumën e kërkuar, e kjo sidomos duke u bazuar në aktgjykimin e plotfuqishëm penal P.nr.443/10, të datës 09.10.2014, ku i padituri vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, e cila i është vënë atij në barrë. Gjithashtu kërkesëpadija është provuar edhe përmes faturës së administruar nga ana e gjykatës, e cila është hartuar konform rregulloreve dhe procedurave të aprovuara nga zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike (ZRRE). Andaj mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovoi në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, përfshi këtu edhe shpenzimet procedurale, përkatësisht shpenzimet në emër të taksës gjyqësore shumën në lartësi prej 15 euro, më gjerësisht sikurse në fjalën e tij të fundit.

I padituri Z. S. Sh., gjykatës nuk i ka parashtruar përgjigje me shkrim në padi.

Siç u cek edhe më lartë, seanca e shqyrtimit kryesor për këtë çështje juridiko kontestimore është mbajtur në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 423.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: aktgjykimin e plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.443/10, të datës 09.10.2014 dhe faturën me nr. DPZ10HP05198, të datës 23.03.2010.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadija e paditëses është tërësisht e bazuar.

Nga leximi në aktgjykimin e plotëfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.443/10, të datës 09.10.2014, gjykata e ka provuar faktin se këtu i padituri Z. S. Sh. është shpallur fajtorë pasi që ka kryer vepër penale të vjedhjes nga neni 252, paragrafi 1 të KPK-së, i cili prej datës së pavërtetuar e deri me datë 18.01.2010, në shtëpinë e tij në fshatin A. komuna e Prizrenit, gjatë kontrollit të njësorit dhe konstatimit të shërbimit të specializuar është konstatuar se ka shfrytëzuar energjinë elektrike nga njëtori ashtu që në anën e majtë të tij e ka futur shiritin e filmit, përmes të cilit është penguar puna e diskut, me ç'rast nuk është regjistruar energjia e shpenzuar, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Nga leximi faturën me nr.DPZ10HP05198, të datës 23.03.2010, gjykata ka konstatuar se dëmi të cilin i padituri ia ka shkaktuar këtu paditëses është në shumën prej 456,44 euro, më gjerësisht sikurse në këtë faturë.

Baza ligjore

Duke pasur parasysh kohën e shkaktimit të dëmit, bazuar në nenin 1057 të Ligjit të ri për Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr.04/L-007, i cili ka hyrë në fuqi me 20.12.2012, gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore megjithatë zbatohet Ligji i vjetër për Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD) i ish RSFJ-së.

Me nenin 154 al.1 të LMD-së, është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *“në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se ***“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”***, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se *“Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...”* gjë që sipas bindjes së gjykatës, në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me kërkesa të tilla.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, është provuar se këtu i padituri Z. S. Sh. nga fshati A. komuna e Prizrenit, i ka shkaktuar dëm këtu paditëses përmes shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, për çka i padituri ka detyrim për kompensimin e këtij dëmi ndaj këtu paditëses. Në të vërtetë, paditësja i ka ofruar gjykatës si provë aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.443/10, të datës 09.10.2014, ku me të njëjtin vërtetohet se këtu i padituri është shpallur fajtorë për veprën penale të vjedhjes, nga neni 252 paragrafi 1 të KPK-së, me ç’rast edhe është konstatuar shuma e dëmit të shkaktuar. Po ashtu paditësja si provë gjykatës i’a ka parashtruar edhe faturën mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike me nr. DPZ10HP05198, të datës 23.03.2010, e cila është hartuar konform rregullave dhe procedurave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRREE), të cilës gjykata i’a falë besimin e plotë, e përmes të të cilave prova është vërtetuar lartësia e shumës së shpenzuar të energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurit, respektivisht lartësia e dëmit që i është shkaktuar këtu paditëses nga ana e të paditurit. Mbi bazën e të lartcekurave gjykata gjeti se kërkespadia e paditëses është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palës ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 të LPK-së dhe atë vetëm për shpenzimet në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 15 euro, siç edhe janë kërkuar nga ana e vet paditëses.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.516/15, datë 29.10.2015

Procesmbajtësja
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.